



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

### E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.07.2019,  
duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Agim Gashi, Jeta Rafuna, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Vala Peshku, Halim Halimi, Sami Boroci, Genc Sherifi dhe Egzon Azemi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Habib Qorri, përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrotjtes dhe Shpëtimit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Pretime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Eroll Raskova, udhëheqës i Sektorit të buxhetit dhe financave, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja dhe Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta, kryesues**.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se diskutimi publik për Planin e mobilitetit ka përfunduar, por nuk janë inkorporuar kërkesat që i kanë pasur qytetarët, kështu që për mbledhjen e Kuvendit materiali do të jetë i kompletuar.

Njëherësh ai propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi", që është kërkesë nga kryeministri, dhe është duke e përgatitur materialin Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo do të jetë e gatshme për mbledhjen e radhës.

**Agim Gashi** tha se nuk është mirë të bëhet praktikë e përhershme, që në secilën mbledhje, brenda mbledhjes me ardhur me propozime, por duhet krijuar mundësitet që materiali të sillet me kohë.

Eman Rrahmani u shpreh i pajtimit me zotëri Gashin, duke thënë se nëse i votojmë dhe i miratojmë këto dy pika, duhet me u siguruar se materiali ka me ardhur me e-mail tani, nesër kur të dërgohet, në mënyrë që me pasur kohë me lexuar dhe me analizuar. Po ashtu, te Rregullorja e parkingjeve vërejtjet që kanë qenë nuk janë inkorporuar fare.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky

**REND I DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);
3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1prill - 30 qershori 2019 (TM2);
4. Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimit;
5. Propozimrregullore mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
6. Propozimrregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi";
8. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Pika e dytë**

Propozimvendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës ( PMQU).

Genc Bashota tha se sa i përket Planit të mobilitetit, ka qenë në diskutim publik një muaj dhe kanë qenë 3 - 4 komentet, pa emër e mbiemër, nga 2-3 fjali të qytetarëve, nuk ka pasur ndonjë vërejtje apo sugjerim, kështu që duhet të dalë edhe një herë në votim.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshmë urban të Prishtinës (PMQU) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 prill – 30 qershor 2019 (TM2).**

**Halim Halimi**, sa i përket raportit finanziar buxhetor për periudhën 1 prill – 30 qershor 2019 (TM2), u shpreh se është mirë që të hyrat krahasuar me periudhën paraprake të vitit paraprak, kanë shënuar një rritje dhe krahasuar me TM I, prapë është një rritje e të hyrave në buxhet. Por, ne e dimë se buxheti planifikohet 31 milionë të hyra, andaj unë mendoj se ka mundur të inkasohen edhe më tepër, sepse tash ka hyrë edhe një kategori e re, siç është tatimi mbi pronën e paluajtshme për tokën bujqësore. Sa i përket të hyrave, është një trend deri diku mirë, por më brengos çështja e shpenzimeve, sidomos te shpenzimet kapitale, prej këtij buxheti të paraparë janë harxhuar vetëm 3,755 milionë ose 7,77%. Në bazë të këtyre shifrave shihet se Komuna është duke çaluar çdo herë e më shumë, por duhet Kryetari të ndërmarrë masa ndaj dikastereve përkatës që t'i rrisin shpenzimet kapitale. Nëse i analizojmë sipas drejtive, edhe në këtë TM 2 shohim se disa drejtori shpenzime të buxhetit kanë 0, kjo është për t'u habitur! Po ashtu, detyrimet kontigjente dita ditës në Komunën e Prishtinës shkojnë duke u rritur, si në TM 1, ashtu edhe te TM 2.

**Vala Peshku** shprehu shqetësimin se KPF shpesh nuk po përngjan në Komitet, sikurse tash. Në fakt, ne kemi disa raporte përpara, të cilat pritet t'i diskutojmë në Kuvend, tash është vetëm e kotë me diskutuar, se nuk i kemi as drejtorët këtu, që të mund të ballafaqohemi me ta, kështu që kemi nevojë me qenë pak më ekspedativë, mos me humbur kohë me muhabete që nuk kanë përgjigje sa i përket këtu ku jemi.

**Halim Halimi** u shpreh se kot presim ne këtu, asnjë drejtor nuk po vjen, thuajse asnjëherë, kështu që ne nuk kemi çka mbajmë KPF nëse nuk i diskutojmë çështjet këtu.

**Agim Gashi** theksoi se Komiteti është filter i punës së Kuvendit, trup punues dhe mirë që diskutohen gjërat, por mungesa e drejtorëve e shkëput vazhdimësinë e bashkëpunimit në mes të ekzekutivit dhe legjislacionit dhe është obligim ligjor. Nëse duam që shteti të funksionojë, Komuna si institucion lokal, duhet të bashkëpunojnë organet mes veti, se nuk mund të ketë sukses ekzekutivi pa Kuvend, as Kuvendi pa ekzekutiv.

Sa i përket raportit, ky është raport i Kryetarit të Komunës dhe këtë e harton kryetari me bashkëpunëtorë, duke përfshirë të gjithë drejtorët në sektorët buxhetor. P.sh., në faqen 11 thuhet: "Buxheti për të gjitha kategoritë ekonomike për vitin 2019, është planifikuar në vlerë prej 111 milionë €, kur është planifikuar, kush e ka planifikuar 111 milionë €, askush nuk e ka planifikuar, është krijuar 111 milionë €, ky dokument është zyrtar, i cili arkivohet. Kjo po del që në tetor të vitit 2018 kemi miratuar një buxhet prej 111 milionë €. Atëherë është miratuar 72 milionë €, mirëpo më vonë, pas përllogaritjes vjetore buxhetore, na kanë tepruar 23 milionë € e diçka dhe iu

kanë bashkëngjitur, më vonë është bashkëngjitur Ligji për Prishtinën edhe këtu iu ka bashkëngjitur 12-13 milionë € dhe kur i mbledhim bëjnë 111 milionë €. Ky dokument votohet në Kuvend, andaj këtë fjali duhet me riformuluar, sepse është dokument valid që arkivohet. Po ashtu, ceku se shqetësuese është çështja te pasqyrat sipas drejtive, nga 147 kode buxhetore, në 121 kode nuk ka ngritje të progresit, është 0 progres, që nuk ka ndryshua asgjë nga TM 1. Kjo është për t'u brengosur dhe ky është një paralajmërim që kemi me pasur prapë një bartje në fund, e që do të jetë shumë më të madhe se e vitit të kaluar.

**Agim Kuleta, kryesues,** theksoi se kjo vërejtja që ishte për faqen 11, a do të mund të ishte "parashihet të jetë në vlerë 111 milionë €".

**Agim Gashi** tha jo, buxheti është rritur, vlera e planifikimit ka qenë 72 milionë €, është rritur nga dy burime tjera, nga bartja dhe nga Ligji për Prishtinën.

**Vala Peshku** theksoi se duhet cekur kronologjia e ngjarjeve, mirë e ka zotëri Agimi.

**Eroll Raskova** dha sqarime, duke cekur se pajtohet pak me vërejtjen e zotëri Agimit, por në këtë rast kjo paraqet shumën totale të buxhetit aktual që e kemi në vitin 2019, është ajo që po e përfshin edhe buxhetin, po e përfshin edhe bartjen. Ne i kemi qituri mjetet në dispozicion për vitin 2019, d.m.th. kjo vlerë përfshin të gjitha, pra kemi përfshirë sa kemi mjete edhe me buxhet, edhe me bartje.

**Agim Gashi** tha, por duhet të ceken kështu siç po thua ti, se nuk është e shkruara kështu në raport.

**Vala Peshku** theksoi se nganjëherë presjet e ndërrojnë kuptimin e fjalisë, ajo që po thotë zotëri Agimi është plotësisht e vërtetë. Ne, ky Kuvend nuk ka planifikuar këtë buxhet 111 milionë € në shtator të vitit 2018. Vetë nocioni "është planifikuar", është në kundërshti me kronologjinë e ngjarjeve që kanë ndodhur.

**Eroll Raskova** tha se në faqen 11 mundemi me shtua edhe atë pjesën ndarëse.

**Agim Kuleta** u shpreh se rekomandimet i morët, për Kuvend materiali duhet ardhur me ndryshime.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 prill - 30 qershor 2019 (TM2) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e katërt

**Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimit.**

**Osman Bllaca** tha se Raporti i audimit nuk ndryshon asgjë, është pozitiv ai që ka ardhur, në këtë çështje kemi edhe numër më të vogël të rekomandime, janë 4 rekomandime më pak se vitin e kaluar dhe është pozitiv, gjithë numrat, pasqyrat financiare janë në përputhje me Ligjin, me përjashtim 1.8 milionë € që janë bërë prej kategorisë së kapitaleve, janë bërë për mallra dhe shërbime. Sa i përket Planit të veprimit, këtë vit iu kemi sjellë edhe Planin e veprimit për 21 rekomandime, të cilat janë bërë nga Auditori për të gjeturat të cilat janë në raport për çdonjëren.

**Agim Gashi** tha se raporti është pozitiv në aspektin e pasqyrimit të gjendjes reale dhe është i pa modifikuar, d.m.th. është real, mirëpo nuk është mirë me na u përsërítë gjendja e rapportit paraprak, kur auditori rekomandon 25 rekomandime, prej tyre ka rekomandime të paadresuara, nuk është mirë me na u përsërítur gjërat e njëjtë prej vitit në vit.

Ajo që më brengos në aspektin e përgjithshëm, nuk është mirë me u shpenzua ato mjete pa vendim të Kuvendit, se asnë GP, asnë këshilltar nuk voton kundër kur të vie një propozim për pagesën e shpenzimeve, ta them për "Trafikun Urban", ne e dimë atë kredi nuk mundet me paguar Kompania, por duhet Komuna. Pse nuk e sillni në Kuvend me miratuar Kuvendi, në mënyrë që kur ta auditon buxhetin e këtij viti Auditori, nëse e merr këtë lëndë, ka me na dhënë vërejtje se të ka dhënë edhe vitin e kaluar, shpenzimi i mjeteve pa vendim të Kuvendit. Kryetari ka të drejtë të limituar deri 9.999 € pa vendim të Kuvendit, e mbi këtë shumë duhet të sillet në Kuvend, çdo ndryshim në agjencinë e planifikuar duhet të sillet në Kuvend dhe ai e voton.

**Eman Rahmani**, lidhur me raportin tha se do të ndalem te kjo çështje, tjetërsimi i mjeteve prej investimeve kapitale në mallra dhe shërbime. Këtë çështje unë e kam vërejtur në fillim të raportimit të tremujorit dhe nuk kam marrë përgjigje, përkundër pyetjeve, e-mailit e shkresave se ku kanë shkuar mjetet. Në raport na është paraqitur investimi te Tregu i qytetit, ku ne e shihnim që aty nuk ka pasur investime dhe ka qenë një shumë 200-300 mijë €. I kam drejtuar pyetje drejtoreshës, kryetarit, nënkyetarit dhe asnë nuk më kanë kthyer përgjigje se ku janë shkuar këto mjetë, mirëpo pas 4 -5 muajve e kanë bërë publike në një mënyrë indirekte, se një pjesë e këtyre mjeteve që kanë qenë të dedikuara për Tregun e qytetit, janë bërë pagesat e kredisë së autobusëve.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i auditimit për vitin 2018 dhe Plani i veprimit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e pestë

**Propozimrregullore mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.**

**Osman Bllaca** tha se kjo është një rregullore e fëmijëve, që ka kaluar në diskutim publik, e kemi mbajtur diskutimin publik, nuk ka pasur asnë ndryshim, sugjerim as komente, është e njëjtë që ka qenë kur është votuar për të dalë në diskutim publik.

**Agim Gashi** theksoi se në faqen 6, nen 17, pika 17.2, nënpika e), çka nënkupton shprehja "sipas specifikacioneve të Komunës".

Pretime Preniqi dha sqarime lidhur me këtë.

**Agim Gashi** tha se kjo pikë duhet të shikohet se është e pakuptimtë "sipas specifikacioneve" dhe të gjendet shprehja adekuate. Te nen 13, propozoj që të shtohet edhe një pikë, 13.11, kryetar -i/ja të ketë selinë pranë Sektorit për të drejtat e njeriut. Njëherësh propozoj që nen 7, pika 7.1 të riformulohet kështu: "Gjatë një viti kalendarik janë obliguese katër mbledhje të Asamblesë". Te nen 2, propozoi që të shtohet pika 2.9: "Nxitja e ndjenjës për t'u marrë me aktivitete institucionale dhe politike".

**Egzon Azemi** tha se kjo është pyetje dhe sugjerim. Te neni 6, pika 6.6 thuhet: "Për zgjidhja e kandidatëve bëhet përmes procesit të votimit të hapur ose të mbyllur", mendoj se më mirë është të jetë vetëm i mbyllur.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se duhet të jenë të dy format e votimit.

**Egzon Azemi** u shpreh se pavarësisht që janë fëmijë, janë prej klasës 6-8, që i bie se është njëfarë moshe madhore, votimi i hapur është pak problem, se te votimi i hapur ndikojnë profesorët, andaj më demokratik është votimi i mbyllur.

**Vala Peshku** tha se ne nuk mundemi që gabimet tona, të të rriturve, me ua përcjellë atyre, nëse po dëshirojmë me i mësuar diçka fëmijët, atëherë i mësojmë çka mos me bërë, gjërat që i kemi bërë ne si të rritur e ata nuk duhet bërë.

Qasja e fëmijëve dhe shtylla e arsimit te ne është tepër e ndjeshme, edhe sa herë do të ketë reagime të tillë që ne duam me ua cenuar sadopak të drejtën e tyre, unë kam me reaguar, nuk duhet dhe nuk guxojmë me lejuar që gabimet që ne i kemi bërë, paranojat dhe frikën që ne i kemi prej sistemeve të ndryshme me ua përcjellë fëmijëve. Fëmijët duhet me i mësuar me qenë më të mirë se ne, më të hapur se ne, më të sinqertë se ne, e jo me i mbyllur se është keqedukim.

**Egzon Azemi** tha se të drejtën më të madhe ua jap fëmijës kur ua ofron këtë mënyrë të votimit të mbyllur, sepse për votimin ka me ditur vetëm ai dhe letra, pra ia ofron një kompetencë shumë të madhe.

**Vala Peshku** shprehu mendimin se është mirë që fëmijët të vendosin vetë si të dëshirojnë, votim të hapur apo të mbyllur.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja mbi themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimrregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës.**

**Agim Gashi** theksoi se neni 22 duhet të riformulohet, sepse nuk janë marrë parasysh vërejtjet që i kemi paraqitur në leximin e parë në Komitet dhe Kuvend, kështu që neni 22.1 duhet të harmonizohet me nenin 17 dhe 18. Neni 16, të gjitha çmimoret, biletat e autobusëve dhe taksat e vlerave i vendos Kuvendi, por këtu thotë se i vendos Kryetari. Mendoj se nuk është mirë me ia lënë atë barrë Kryetarit. Neni 16, thuhet: "Çmimi propozohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në bazë vjetore, me miratim paraprak nga Kryetari", këtu duhet të shtohet: "...me miratim nga Kuvendi i Komunës". Neni 4.1.1, edhe këtë pikë duhet me shikuar, duhet të rregullohet.

**Fatos Dibra** në aspektin gjuhësor është dashur ta rregullojë lektori, nëse ka qenë në lekturë.

**Eman Rrahmani** tha se ne i kemi dhënë disa propozime në Kuvend e që nuk janë këtu në Propozimrregullore, po ashtu kanë qenë disa propozime prej qytetarëve e që nuk janë.

**Habib Qorri** tha se i kemi marrë propozimet edhe prej diskutimit publik dhe prej Kuvendit, të gjitha i kemi marrë dhe ndryshimet do t'i inkorporojmë në rregullore, edhe kjo nëse shkon përmes Kuvendit, miratimi i çmimores, këto tarifa që caktohen, dhe ju keni propozuar edhe te çmimoret dhe te kjo që ke përmes Kuvendit. Është një plan-menaxhimi i Prishtina Parkingut, që është bërë me një analizë dhe një studim të mirë, që i ka nxjerrë edhe me zona edhe me tarifa edhe pagesat, duke filluar prej atyre një orësh deri te ato që janë afatgjatë. Të gjitha këto do t'i inkorporojmë në Rregullore, por si grup punues ende nuk kemi arritur me i inkorporuar në Rregullore nen për nen.

**Eman Rahmani** shprehu mendimin se ajo pjesë duhet të përfshihet në Rregullore dhe të miratohet bashkë me të.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se çmimorja mund të jetë pastaj anekse i Rregullores. Këtë Rregullore nuk mund ta implementosh pa çmimore, e Prishtina Parking nuk është kompetente me caktuar çmimore për qytetarët e Prishtinës, kompetent është vetëm Kuvendi, andaj ata mund të ndihmojnë në aspektin profesional, mund të punojnë me juve bashkë, ju t'i propozoni, shfrytëzoni edhe grupet e interesit dhe qytetarët, me i pa edhe specifikat e lagjeve. Kjo rregullore do të bëhet e zbatueshme kur bëhet harmonizimi i çmimores me gjendjen reale në terren. Mos i kopjoni ato çmimore dhe rregullore nga shtetet tjera, bazohuni me terrenin me të cilin keni me u ballafaquar, se ju keni me pasur probleme pastaj gjatë implementimit. Nëse ne bëhem naivë dhe e votojmë qorrash, atëherë edhe ne kemi me qenë bashkëfajtorë me ju.

**Agim Kuleta, kryesues** kërkoi të dijë se a mundet materiali me qenë i gatshëm, me këto plotësime, për mbledhjen e rrallës.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e shtatë

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi".**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësja  
Shyrete Islami

Faqe 7 nga 7

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta

